

# PHI LAN THR OPY

*edicioni 2*

*hapësira e dedikuar*

*për* FILANTROPINË

#philanthropy

— kontakt :   



Rockefeller  
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI  
LAN  
THR  
OPY

*hapësira e dedikuar*

*për* FILANTROPINË

# Në këtë edicion



**5**

Rreth revistës

**9**

Të dhëna rreth  
aktivitetit filantropik

janar - qershor 2021

**19**

Rrathë Dhurues 2021

**25**

Smile.al

Platforma e parë  
Shqiptare crowdfunding

**27**

**Intervista me  
përfaqësues të  
nismave filantropike  
në vend**

Alfred Muharremi  
Shërbimi Social Shtetëror

**35**

**Fushata në ndihmë të  
personave në nevojë**

**38**

**Fondacionet Komunitare**

**42**

**Global Giving Index**

***Mirë se vini në edicionin e dytë të revistës  
Philanthropy!***

Në këtë edicion, ju do të njiheni me nismat e shumta të ndërmarra gjatë gjashtë muajve të fundit në lidhje me promovimin dhe zhvillimin e filantropisë në Shqipëri.

Një fokus të veçantë në këtë editorial zë ngritja e fondeve, përmes ankandit të dhurimit live – “Rrathë Dhurues” dhe platformës së parë shqiptare të ngritjes së fondeve SMILE.al.

Ankandi i dhurimit live “Rrathë Dhurues 2021” bëri bashkë rreth 70 individë nga komuniteti i biznesit, sektori jofitimprurës, media, bota akademike etj., të cilët ofruan dhurime në vlerë monetare, mallra/produkte apo dhe në shërbime profesionale për tre kauzat sociale të prezantuara gjatë eventit. Shuma totale e grumbulluar prej 3,035,150 Lekë tejkaloi ndjeshëm objektivin e synuar prej 900,000 Lekë, duke rikonfirmuar edhe një herë sesa solidare është shoqëria jonë ndaj mbështetjes së komuniteteve në nevojë. Një aspekt tjetër i

R  
r  
e  
t  
h  
e  
n  
s  
h



rëndësishëm i këtij eventi është se nisma të tilla filantropike përtej ndihmës konkrete për personat dhe komunitetet në nevojë, mund të shërbejnë dhe si pikënisje apo shtysë për dhurime më të mëdha.

Në maj të vitit 2021 u lançua platforma e parë shqiptare e ngritjes së fondeve SMILE.al, që synon të rrisë vetëdijen e publikut si dhe të inkurajojë dhe motivojë individët për të kontribuar në mbështetjen e iniciativave komunitare, duke adresuar nevojat e grupeve të marginalizuara në nivel vendor. Platforma vjen si një partneritet strategjik ndërmjet aktorëve me një interes të lartë për përgjegjësinë sociale, si Fondacioni Credins Bank, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Fondacioni Vodafone dhe Grant Thornton Albania. Secili partner kontribuon në promovimin dhe mirëfunksionimin e platformës ndërsa garanton një përzgjedhje të suksesshme dhe të paanshme të iniciativave që do të mbështeten.

Për më tepër, një seksion shumë i rëndësishëm i këtij edicioni janë të dhënat dhe faktet nga monitorimi mujor i aktivitetit filantropik në vend, të cilat ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të panoramës filantropike në Shqipëri gjatë gjysmës së parë të vitit 2021.

Në këtë publikim, kemi kënaqësinë t'ju prezantojmë me rolin dhe kontributin e "Shërbimit Social Shtetëror" dhe ndihmesën e këtij institucioni në orientimin e dhurimeve për grupet në nevojë. Gjithashtu intervista me Z. Alfred Muharemi, anëtar i "Lëvizjes për Advokimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe të Rinjve pa Kujdes Prindëror", prezanton disa nga veprimtaritë e zhvilluara në mbështetje të fëmijëve dhe të rinjve pa kujdes prindëror dhe grave kryefamiljare përmes ofrimit të mundësive të integritetit dhe punësimit.

Një ndër nismat më të fundit në fushën e filantropisë është mbështetja për zhvillimin e fondacioneve komunitare në Shqipëri. Forume publike diskutimi me ekspertë evropianë dhe përfaqësues të sektorit



jofitimprurës dhe fitimprurës në Shqipëri u zhvilluan për të rritur ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut në lidhje me konceptin dhe modelet e fondacioneve komunitare.

Shqipëria është tanimë pjesë e hartës së WINGS. WINGS është një forum për zgjidhje bashkëpunuese të problemeve, ku aktorët më të spikatur të komunitetit filantropik mund të ndajnë informacion dhe të mësojnë nga njëri-tjetri. WINGS numëron më shumë se 180 organizata anëtare që shtrihen në 57 shtete, çka nënkupton se kjo është një arritje e dyfishtë për Partnerët Shqipëri si organizatë jofitimprurëse ashtu edhe për përfaqësim në rang vendi.

Nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e radhës, ju lutem shkruani tek [kkeruti@partnersalbania.org](mailto:kkeruti@partnersalbania.org)

*Lexim të këndshëm!*





T Ë D H Ë N A  
R R E T H  
A K T I V I T E T I T  
F I L A N T R O P I K


J A N A R - Q E R S H O R 2 0 2 1

Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2021, të prezantuara në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe raportimin e rregullt mujor. Metodologjia e përdorur është bazuar në të dhëna të mbledhura nga hulumtimi ditor i mediave, përfshi ato sociale si dhe nga institucionet publike dhe jo-publike gjatë periudhës **janar - qershor 2021**.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.


## Numri i dhurimeve




- Monetare (90.17%)
- Mallra / Produkte (6.84%)
- Shërbime (1.28%)
- Miks (0.85%)
- Punë Vullnetare (0.85%)

## Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë


Mijë Lekë



Dhurime në grup



Dhurime individuale



Forma e dhurimit



Evente  
22

234


Dhurime të drejtpërdrejta  
76

Fushata për ngritjen e fondeve  
136


Dhurime në grup




Dhurime individuale



Dhurime në grup



Dhurime individuale




# Dhuresit sipas Formës së dhurimit


- Korporatë
- Individë
- OJF
- Grup dhuruesish
- E Panjohur
- NVM
- Institucion Ndërkombëtar
- Institucion Publik
- Komunitet Fetar



- Grup dhuruesish
- Korporatë
- Individë
- Miks
- NVM
- OJF
- Komunitet Fetar
- Institucion Ndërkombëtar
- Institucion Publik



- Korporatë
- OJF
- Grup dhuruesish
- Miks
- Individë



\*Dhuresit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera në secilën prej kategorive të "Formës së dhurimit".

# Fushata për ngritjen e fondeve

**32** Thirrje për Dhurim

**6** Fushata përmes medias sociale

**7** Fushata përmes medias vizive

**6** Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social\*

**46** Fushata përmes platformave Crowdfunding

**33** Mega Fushatë



**6** Fushata përmes medias sociale & platformave Crowdfunding

# Evente

**22** Evente live


\*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

## Numri total i dhuruesve\*



\*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

## Vlera sipas natyrës së dhuruesit



## DHURUESIT KRYESOR sipas numrit të dhurimeve

- #1 Credins Bank
- #2 Fondacioni "Shpresë për Botën"
- #3 Balfin Group
- #4 Bethany Social Services
- #5 CFO Pharma

## 3 DHURUESIT KRYESOR sipas vlerës së dhurimeve

### #1 Grup dhuruesish 26,128,548 Lekë

Fushatë crowdfunding për të ndihmuar personat që përballen me probleme të ndryshme shëndetësore në Shqipëri.

### #2 Grup dhuruesish 17,572,088 Lekë

Fushata crowdfunding për vogëlushët Elisjano dhe Omer, të cilët po përballen me probleme të rënda shëndetësore.


### #3 Grup dhuruesish 13,212,231 Lekë

Fushata crowdfunding për Bonën 3 vjeçare në luftën e saj kundër sëmundjes së rëndë që e ka prekur.




## Përfituesit Përfundimtar


- Publik i Gjerë - Vështirësi Ekonomike (22.65%)
- Fëmijë & Të Rinjtë - Me aftësi të kufizuar (19.66%)
- Fëmijë & Të Rinjtë - Pa Përkujdesje Prindërore (17.95%)
- Të Rritur - Të Moshuar (8.55%)
- Të Rritur - Me aftësi të kufizuar (5.56%)
- Publik i Gjerë - Zonë Specifike (5.13%)
- Fëmijë & Të Rinjtë - Zonë Specifike (4.27%)
- Publik i Gjerë - Me aftësi të kufizuara (3.85%)
- Gra & Fëmijë - Viktima të Dhunës dhe Trafikimit (2.56%)
- Publik i Gjerë (2.14%)
- Fëmijë & Të Rinjtë - Vështirësi Ekonomike (1.71%)
- Të Rritur - Prindër të Vetëm (1.71%)
- Mbrojtja e Kafshëve (0.85%)
- Miks (0.85%)
- Publik i Gjerë - Komunitetet Fetare (0.85%)
- Publik i Gjerë - Komunitetet Minoritare (0.85%)
- Tjetër (0.43%)
- Publik i Gjerë - Sëmundje Terminale (0.43%)





## Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve



## Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve





**Diaspora**




**2.14%**


**Shtetas të huaj**



**0.85%**



Shqipëria



**Diaspora**




**Shtetas të huaj**

## Qëllimi i dhurimit

- Mbështetje e grupeve të marginalizuara (37.18)
- Zbutja e varfërisë (23.08%)
- Shëndetësi (22.22%)
- Edukim (3.42%)
- Art dhe Kulturë (2.99%)
- Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit (2.14%)
- Dhurime sezonale (2.14%)
- Sport (1.71%)
- Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore (1.71%)
- Trashëgimi kulturore (0.85%)
- Mbrojtja e kafshëve (0.85%)
- Zhvillimi ekonomik (0.43%)


- Miks (0.43%)
- Tjetër (0.43%)
- Sipërmarrje Sociale (0.43%)





# Fjalorth

## Kanalet e dhurimit



**Dhurim i drejtpërdrejtë** - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

**Fushata për ngritjen e fondeve** - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

**Evente** - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

**Zbutja e Varfërisë** - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

**Dhurime Sezonale** - Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

**Publik i Gjerë** - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës

**Grup dhuruesish** - Grupe të mëdha ose të vogla individësh që dhurojnë

**Miks** - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

**NVM** - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

**Platforma Crowdfunding (Individë apo familje)** - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

**Platforma Crowdfunding (OJF)** - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

**Institucione Private** - Biznese



# R R A T H Ë D H U R U E S



2 4 Q E R S H O R 2 0 2 1

Në qershor 2021 u organizua edicioni i dytë i eventit "Rrathë Dhurues".

Rrathë Dhurues është një event i dhurimit live, i cili u jep individëve mundësinë të bashkohen rreth një qëllimi filantropik për të mbështetur iniciativat e përzgjedhura prej tyre. Stimulimi i dhurimeve individuale dhe korporativë për veprimtarinë e OShC-ve që synojnë një ndryshim social dhe një transformim pozitiv e të qëndrueshëm të komunitetit, shoqërisë dhe mjedisit janë vlera thelbësore e eventit.





#RrathëDhuruës  
*Shqipëri*



# RRAITHË DHUR



Eventi i qershorit mbledhi së bashku rreth 70 përfaqësues nga sektori i biznesit, komuniteti i donatorëve, institucionet diplomatike, shoqëria civile, media, arti, etj., të cilët ofruan kontributin e tyre financiar, material dhe në natyrë në një shumë totale prej 3,035,150 Lekë (duke tejkaluar objektivin e synuar prej 900,000 Lekë). Ndonëse nuk ka incentiva fiskale apo kuadër ligjor që rregullon dhurimet individuale, dhurimet individuale në këtë event ishin më të lartat në numër dhe konkurruan me dhurimet e korporatave.

Kontributet e mbledhura do të mbështesin iniciativat e mëposhtme:



# UES 2021



## ***Hapa të vegjël***

Hapa të vegjël synon të përmirësojë jetesën e fëmijëve të komunitetit “Lana Bregas” në Tiranë, nëpërmjet ofrimit të një këndi lojrash në përmbushje të së drejtës së tyre për t’u argëtuar dhe për të pasur një fëmijëri të lumtur. Mbi 126 fëmijë të këtij komuniteti kalojnë ditën në një mjedis që nuk ofron asnjë mundësi argëtimi, ndaj shpesh një pjesë e tyre, edhe të pashoqëruar nga prindërit, largohen për të kaluar kohën në parqe lojrash me distanca të largëta. Kjo përbën një rrezik potencial, pasi fëmijët mund të bien pre e abuzimeve të mundshme nga të panjohur. Iniciativa do të mundësojë argëtimin e fëmijëve por edhe do të ndikojë në vetëdijësimin e prindërve mbi rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në aktivitete argëtuese, e rëndësishme kjo jo vetëm për zhvillimin e tyre social, por mbi të gjitha si një e drejtë e tyre legjitime, edhe pse jetojnë në një komunitet të varfërisë ekstreme. Organizata zbatuese është “Nisma për Ndryshim Shoqëror” - ARSIS”.



## ***Qendra Multifunktionale Thumanë***

Thumana është një nga zonat më të prekura nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019. Humbja e jetëve të banorëve të këtij komuniteti, godina banimi të shkatërruara dhe të dëmtuara, shkolla dhe institucione të tjera të rrënuara, ishin pasojat e menjëhershme të tij. Nevoja për shërbime psikologjike dhe sociale është ende e lartë, sidomos për familjet me fëmijë dhe të rinj, për hir të traumës dhe frikës nga fatkeqësi të tilla natyrore. Qendra Multifunktionale Thumanë e nisi veprimtarinë e saj në maj të vitit 2020 në përgjigje të nevojave të komunitetit, dhe synon rivitalizimin e jetës sociale të tij përmes ofrimit të një mjedisi të përshtatshëm ku fëmijët dhe të rinjtë të kalojnë kohë, socializohen dhe integrohen. Qendra ofron ambiente studimi, kënd lojrash, kënd interneti për rreth 80 fëmijë dhe të rinj. Duke qenë Qendra e vetme në zonë, përmes mbështetjes së kërkuar synon të zgjerojë aktivitetet sociale dhe t'i kthejë ato në shërbime të qëndrueshme me impakt afatgjatë. Organizata zbatuese është “Organizata Vizioni i Ri”.



## ***Këndi i Studimit***

Këndi i Studimit synon të mundësojë ambiente të përshtatshme studimi për fëmijë të cilët jetojnë në familje me kushte të pafavorshme ekonomike, në zonën e Tufinës në Tiranë. Për shkak të situatave problematike të mbivendosura të këtyre familjeve dhe nevojës për të siguruar ushqim, shkollimi i fëmijëve zhvendoset nga prioritetet bazike dhe si rrjedhim nxit mundësinë për mos ndjekje të rregullt të shkollës dhe në rastet më ekstreme në braktisjen e saj. Përmes kësaj nisme do të mbështeten 14 familje, të cilat kanë 3 deri në 5 fëmijë, me një kënd studimi në banesat e tyre dhe mjetet e duhura shkollore për fëmijët, duke mundësuar kështu kushtet bazë por të duhura ku fëmijët të përgatiten për lëndët mësimore. Gjithashtu një kënd studimi i përbashkët në ambientet e Qendrës Ura do të shërbejë për dhjetra fëmijë të tjerë në nevojë. Organizata zbatuese e iniciativës është “Qendra Tek Ura”.





newsntv.al

KREU LIVE TV POLITIKE SHENDETI KRONIKE EKONOMI BOTA SOCIALE PINKNE

### Deklaratë për shtyp – Event “Rrathë Dhurues 2021”

by OeSH — 29/06/2021 - 12:47 Reading Time: 11 mins read



0 SHARES 4 VIEWS


Ankandë i dhurimit Live #RrathëDhurues2021! Një event emocionues nga solidariteti i treguar veçanërisht përmes dhurimeve individuale që këtë vit ishin të konsiderueshme, duke bërë që shuma e arritur të tejkalonte njëshëm objektivin e synuar në mbështetje të tre kauzave sociale. Mirënjohje dhe falenderim për të gjitha kompanitë dhe institucionet që me një ndjenjë të lartë përgjegjësie të biznesit, ofruan mbështetje financiare, materiale dhe konsulencë falas për zhvillimin e tre iniciativave të përzgjedhura. Shuma totale e mbledhur prej 3,035,150 Lekë e tejkaloi objektivin e vendosur prej 900,000 lekë në total, duke konfirmuar edhe njëherë ndjeshmërinë qytetare dhe solidaritetin ndaj komuniteteve në nevojë. Falënderim nga! Alketa Skendaj, Ana Dervishi, Angelina Lina Pistoli, Armira Citozi, Artan Gjergji, Blerina Kurriço Guga, Blerita Cani, Delina Fico, Eda Elbasani, Edira Muadini, Elga Mito, Elira Sakiqi, Elvita Kondili dhe Charles King, Eni Ruci, Dollia Genta, Gledis Gjipali, Herjola Spahiu dhe Erion Spahiu, Jorida Katroshi, Klina...

Ntv.al

EVENTI NË FOKUSIN E MEDIAS



MSC TV



ScanTV



smile.ai






**S M I L E . A L**

**W W W . S M I L E . A L**

Në maj të vitit 2021, u lançua platforma e parë shqiptare për ngritjen e fondeve - **SMILE.al**

Platforma do të mbështesë nisma komunitare të propozuara nga organizatat jofitimprurëse, në fushat e shëndetit dhe solidaritetit, promovimin e trashëgimisë kulturore, mjedisit, sipërmarrjes sociale dhe inovative, edukimit dhe trajnimet si dhe veprimtaritë sportive. Nismat e paraqitura përmes platformës do të mbështeten përmes dhurimeve financiare dhe në natyrë (mallra dhe shërbime profesionale) nga individë dhe subjekte private.





Misioni kryesor i ngritjes së fondeve online është rritja e ndërgjegjësimit tek publiku dhe motivimi i individëve për të kontribuar, sa më shumë që të jetë e mundur, në zbatimin e iniciativave, të nevojshme për komunitetet shqiptare në nevojë.

Platforma Smile.al është një iniciativë e Fondacionit Credins Bank në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Grant Thornton Albania dhe Fondacionin Vodafone Albania. Institucionet partnere do të sigurojnë asistencë teknike për aplikantët në lidhje me zhvillimin e iniciativave dhe do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit të mbështetësve, të nevojshëm për zbatimin e iniciativave.

Thirrja e parë për projekt propozime është e hapur deri më - **20 gusht 2021**.

**I N T E R V I S T A**  
**M E P Ë R F A Q Ë S U E S**  
**T Ë N I S M A V E**  
**F I L A N T R O P I K E N Ë**  
**V E N D**





S O L I D A R I T E T I P Ë R

P E R S O N A T N Ë

N E V O J Ë



# Alfred Muharremi



Anëtar i "LËVIZJA PËR TË  
ADVOKUAR PËR TË DREJTAT E  
FËMIJËVE DHE TË RINJVE PA  
KUJDES PRINDËROR"

**Ju lutem mund të na tregoni ku konsiston nisma juaj dhe arsyet/shtysa për të ndërmarrë një nismë të tillë?**

Së pari, dua të theksoj se unë vij nga komuniteti i fëmijëve pa kujdes prindëror, të rritur në Fshatrat e Fëmijëve SOS në Shqipëri, një organizatë e cila mbështet dhe advokon për fëmijët pa kujdes prindëror. Së bashku me bashkëmoshatarët e mi, të rritur në institucionet e kujdesit social, ne kemi krijuar lëvizjen "Lëvizja për të advokuar për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve pa kujdes prindëror". Lëvizja u krijua në vitin 2013 dhe synon të mbështesë fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror dhe gratë kryefamiljare, të cilat kanë 3 - 4 fëmijë, duke u siguruar mundësi për integrimin dhe punësimin e tyre në mënyrë që t'i fuqizojë dhe t'ju sigurojë pavarësinë ekonomike.

**Cili është grupi i synuar, fushat dhe impakti i ndërhyrjeve?**

"Lëvizja" synon fëmijët, të rinjtë pa kujdes prindëror dhe gratë kryefamiljare me 3-4 fëmijë të cilët janë pjesë e skemave të ndihmës sociale shtetërore.



Pagesa mujore (mbështetja financiare) për përfituesit tanë është një nga skemat mbështetëse të ofruara. Për momentin ne jemi duke mbështetur 591 përfitues. Kjo është bërë e mundur falë dhurimeve individuale dhe të subjekteve private, të cilët kontribuojnë çdo muaj / çdo dy muaj sipas dëshirës me një shumë minimale nga 5,000 - 12,000 Lekë. Falë këtyre dhurimeve, mesatarja e pagesave mujore të shpërndara për përfituesit është afërsisht 4,4 milion Lekë. Si rezultat, 2,200 familje në nevojë janë mbështetur përmes këtij programi. Një nga arritjet e këtij programi është numri i dhuruesve. Rrjeti i dhuruesve përfshin 1,319 individë dhe 218 sipërmarrje që dhurojnë për këtë qëllim.

Përveç kësaj, kemi një program zhvillimi për gratë kryefamiljare. Përveç pagesave mujore, ky program rrit aftësitë dhe kapacitetet e grave për t'i përgatitur ato për tregun e punës dhe përpiqemi t'u sigurojmë pavarësinë ekonomike. Përmes negociatave me institucione publike, private dhe organizatat jofitimprurëse, ne krijojmë mundësi punësimi për to. Gjatë 8 viteve të fundit, 450 gra janë punësuar dhe kanë kontribuar në gjetjen e mundësive të punësimit për gratë e tjera që janë pjesë e programit të zhvillimit.



Kjo tendencë shihet edhe në punësimin e të rinjve pa kujdes prindëror. Që prej fillimit të lëvizjes 1,328 të rinj pa kujdes prindëror janë punësuar në sektorin publik dhe privat.

Një program tjetër lidhet me fushën e arsimit. Ky program mbështet të rinjtë pa kujdes prindëror ose me një prind të vetëm, duke iu ofruar mundësi arsimimi dhe bursa. Si rrjedhojë e bashkëpunimeve me institucionet akademike, veçanërisht me universitetet private, 274 të rinj pa kujdes prindëror kanë patur mundësi të ndjekin studimet universitare dhe të diplomohen.

Përveç këtyre programeve, ne kemi zbatuar gjithashtu disa projekte arsimore, kulturore, rekreative dhe sportive që synojnë një bashkëveprim dhe bashkëjetesë më të mirë ndërmjet përfituesve dhe komunitetit të cilit ne i shërbejmë.



# TË MBËSHTETURA

2200 FAMILLJE



1328 TË RINJ  
TË PUNËSUAR





## **A jeni përballur me ndonjë sfidë në lidhje me dhurimet gjatë pandemisë Covid-19?**

Gjatë dy viteve të fundit, situata e pandemisë globale Covid-19 ndikoi mbi dhurimet. Pjesa më e madhe e dhuruesve tanë privatë janë biznese të vogla. Ata kontribuojnë çdo muaj me rreth 10,000 Lekë për të mbështetur përfituesit tanë. Si rezultat, vitin e kaluar dhurimet pësuan një rënie prej 34%, pasi bizneset e vogla ishin më të rrezikuarat dhe më të brishtat financiarisht për shkak të situatës pandemike. Pavarësisht, ne jemi duke punuar për të zgjeruar rrjetin e dhuruesve tanë dhe për të rikuperuar këtë humbje, në mënyrë që të sigurojmë qëndrueshmërinë e kontributit tonë.

## **Cilat janë planet tuaja të ardhshme?**

"Lëvizja për të advokuar për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve pa kujdes prindëror" do të vazhdojë me programet dhe aktivitetet e saj në përmbushje të misionit tonë. Për momentin jemi duke diskutuar mbi formalizimin e lëvizjes si një organizatë jofitimprurëse.

Ne do të vazhdojmë punën tonë advokuese në mënyrë që të krijojmë kushte më të mira për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror. Ne kemi advokuar dhe do të vazhdojmë të advokojmë pranë institucioneve shtetërore për të hartuar dhe zbatuar programe të kujdesit social për të rinjtë që largohen nga institucionet e kujdesit social, duke synuar t'u mundësojmë atyre që të përballen më lehtësisht me kushtet e tyre të jetesës. Një çështje tjetër që duam të adresojmë bazuar në nevojat e përfituesve tanë është ndryshimi i Ligjit 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë" duke rritur shumën financiare të ndihmës ekonomike për këto familje, si dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 8153 "Për Statusin e Jetimit" i cili do të garantonte integrimin e 28,000 fëmijëve dhe rreth 4200 të rinjve pa kujdes prindëror.

# Shërbimi Social

# Shtetëror



**X H U L I A M U S T A**

Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve

Shërbimi Social Shtetëror është një institucion publik i themeluar në vitin 1996. Misioni i saj është zbatimi i politikave, legjislacionit mbi ndihmën ekonomike, si dhe sigurimi i mbulimit të pagave dhe shërbimeve sociale për personat me aftësi të kufizuara përmes rrjetit të saj të 29 institucioneve të kujdesit social dhe 12 drejtori rajonale në të gjithë vendin.

Që nga viti 2014, Shërbimi Social Shtetëror boton buletin mujor të donatorëve, duke theksuar donatorët, përfituesit dhe natyrën e donacioneve në mbështetje të 29 institucioneve të kujdesit social. Znj. Xhulia Musta, Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve, në Shërbimet Sociale Shtetërore diskutoi më shumë në këtë buletin.

## **Zj. Musta, institucioni që ju përfaqësoni publikon në afate mujore Buletinin e Donacioneve. Kur ka filluar institucioni juaj të publikojë këtë buletin dhe cila është arsyeja?**

Shërbimi Social Shtetëror publikon në faqen zyrtare të web-it Buletinin e Donacioneve që prej vitit 2014, vit i cili përkon me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Publikimi i rregullt i Buletinit të Donacioneve realizohet në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj dhe për efekt të garantimit të transparencës së veprimtarisë së institucioneve publike.

## **Nga të dhënat që keni mbledhur si e shihni trendin e dhurimeve të individëve dhe kompanive në institucionet publike? Është rritur, nga ngelur i njëjtë apo është zvogëluar?**

Trendi i dhurimeve nga individë dhe kompani në institucionet e përkujdesit që varen nga Shërbimi Social Shtetëror në përgjithësi ka mbetur e njëjtë. Ajo që vihet lehtësisht re nga të dhënat e grumbulluara ndër vite nga institucionet e përkujdesit shoqëror është që trendi i dhurimeve rritet më tepër gjatë periudhës së festave të fundvitit, ndërkohë që në pjesën tjetër të vitit janë dhurues thujtse gjithmonë të njëjtat subjekte (individë, OJF dhe biznese).

## **Duke marrë në konsideratë situatën ekonomike të krijuar si rrjedhojë e pandemisë globale COVID – 19, dhurimet janë më tepër në produkte apo shërbime?**

Pavarësisht situatës së pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, në institucionet e përkujdesit shoqëror janë dhuruar gjithmonë produkte, jo shërbime. Dhurimi në produkte i përgjigjet më mirë nevojave konkrete që kanë target grupet në nevojë që marrin shërbime në IPSH tona.

## F U S H A T A

N Ë N D I H M Ë T Ë  
P E R S O N A V E N Ë  
N E V O J Ë



# Fushata

disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve janar - qershor 2021.

## #1

"Shtëpia Rozalba" përfaqëson një vend të sigurt për vajzat e mitura që kanë kaluar përvoja traumatike në jetën e tyre familjare. Qendra ofron trajtim psiko-social, duke i ndihmuar ato të ndërmarrin mundësi të reja për t'u riintegruar në komunitet. Qendra strehon rreth 20 vajza të mitura (të moshës nga 2 deri 18 vjeç) nga situata vështirësie ekstreme. "Shtëpia Rozalba" përfaqëson gjithashtu një vend të sigurt për gratë dhe fëmijët e tyre që janë në situatë shumë të vështirë. Objektivi kryesor i kësaj iniciative është të ofrojë kontribut për të mbështetur dhe forcuar shërbimet e solidaritetit dhe ndihmës për këta të mitur të marginalizuar që jetojnë në varfëri dhe vuajtje.

## #2

Zhaklina Dhimojani Blättler dhuroi pako ushqimore me vlerë 1,000 euro për 40 familje në nevojë, në bashkëpunim me shoqatën 'Shqipëria', Vlorë duke dëshmuar një ndërgjegje qytetare të admirueshme. Dhurime të tilla nga shqiptarë të cilët jetojnë larg vendit të tyre por kontribuojnë e kujdesen për bashkëatdhetarët e tyre janë veçanërisht prekëse dhe domethënëse.

SHTËPIA ROZALBA



40 FAMILJE







### #3

YWCA of Albania në vitin e 13 të fushatës kundër kancerit të gjirit e ka shtrirë shërbimin psikologjik online falas duke përfshirë të gjithë familjen. Kjo vjen një vit pas lançimit të këtij shërbimi për të mbijetuarat me kancer në gji e cila qe një iniciativë mjaft e suksesshme. Tanimë secili anëtar do të ndihmohet dhe mbështetet në betejën personale për të mundur frikën e ankthin e kësaj sëmundjeje.

Për më shumë informacion vizitoni [www.fjongoroze.al](http://www.fjongoroze.al) ose kontaktoni në numrat **0698740489 & 0685287924**.

### #4

Faleminderit kompanisë “LIFE CARE NANNYS” për bashkëpunimin me Food Bank Albania në ndihmë të familjeve në nevojë. Sot, kjo kompani ka dhuruar qumësht formule Aptamil për fëmijët 0-6 muajsh.

Gëzim dhe shëndet për të gjithë fëmijët! Gëzuar 1-Qershorin!



# P È R F È M I J È T





F O N D A C I O N E T  
K O M U N I T A R E




## Forume diskutimi publik mbi zhvillimin e fondacioneve komunitare - Sinergjitë me fondacionet komunitare dhe organizatat mbështetëse të fondacioneve komunitare nga Evropa.

Gjatë muajve mars – prill 2021, Partnerët Shqipëri organizoi tre tryeza diskutimi ndërmjet përfaqësuesve të fondacioneve komunitare dhe organizatave mbështetëse të fondacioneve komunitare nga Evropa me organizata lokale jofitimprurëse dhe kompani private për të diskutuar mbi konceptin e fondacioneve komunitare, rolin dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë.



Dr. Marie-Luise Stoll-Steffan nga "Fondacioni Komunitar i Gjermanisë" theksoi rëndësinë e fondacioneve komunitare si platforma ndërlidhëse për angazhimin e qytetarëve, të afta për të ndërtuar fonde dhe të qenit partner aktiv, i besuar dhe i informuar për të gjithë donatorët. Gjatë prezantimit të saj ajo theksoi se "Fondacionet komunitare janë organizata të qytetarëve, të cilët vetorganizohen. Puna e tyre karakterizohet nga pjesëmarrja dhe transparenca pasi qytetarët mund të votojnë mbi funksionet ekzekutive dhe monitoruese të fondacioneve komunitare. Ajo që i dallon nga organizatat jofitimprurëse është fokusi i gjerë, që do të thotë se fondacionet komunitare mund të bëjnë gjithçka që është e rëndësishme për komunitetin të cilit i shërbejnë". Ajo prezantoi disa praktika të mira nga Gjermania.



Znj. Beata Hirt nga "Healthy City Community Foundation of Slovakia" foli mbi rrugëtimin e Healthy City Community Foundation, një fondacion komunitar i themeluar në Banská Bystrica, Sllovakia. Ajo diskutoi mbi përvojën e saj në krijimin e fondacionit komunitar dhe theksoi se "Fondacioni komunitar mbështet idetë e qytetarëve aktivë, grupeve informale dhe organizatave jofitimprurëse. Fondacionet komunitare mbështeten nga një gamë e gjerë e donatorëve privatë dhe publikë dhe kërkojnë kontribute filantropike kryesisht nga brenda komunitetit". Ajo prezantoi disa nga iniciativat kryesore që "Healthy City Community Foundation" ka zbatuar për të fuqizuar komunitetin lokal dhe për të rritur pjesëmarrjen qytetare.



Znj. Nadiia Luchack nga "Podil'ska Hromada", një fondacion komunitar në Vinnytsia, Ukrainë solli në vëmendjen e pjesëmarrësve disa nga aktivitetet e tyre, duke zhvilluar një kulturë të dhurimit. "Nëse dëshironi të jeni një fondacion komunitar, duhet të punoni me komunitetin, jo vetëm të zbatoni projekte. Ju duhet të dëgjoni dhe të dëgjoheni. Me donatorët duhet të diskutoni se cilat janë përfitimet e tyre në mbështetjen e një fondacioni komunitar dhe pse fondacioni juaj komunitar i njeh më mirë nevojat e komunitetit. Kjo do t'ju ndihmojë të keni një mbështetës dhe partner të vazhdueshëm të veprimtarisë tuaj në komunitet në të ardhmen" ishin disa nga mesazhet kryesore gjatë prezantimit të saj.

# FON DAKOMUNITARE CIONET



*Për të ndarë më shumë informacion mbi fondacionet komunitare, Partnerët Shqipëri përgatiti një [video informuese](#) duke kontribuar në ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut mbi fondacionet komunitare.*






## Takime tematike me shtetet në zhvillim - Iniciativa Evropiane për Fondacionet Komunitare (ECFI)

Iniciativa Evropiane për Fondacionet Komunitare (ECFI) është një iniciativë e angazhuar për forcimin dhe promovimin e lëvizjes së fondacioneve komunitare në Evropë. ECFI bashkëpunon me fondacionet komunitare (CF) dhe organizatat mbështetëse të fondacioneve komunitare (CFSO) kryesisht përmes lehtësimit dhe stimulimit të ndërveprimeve për të mundësuar të mësuarit, rritjen e njohurive dhe fuqizimin. ECFI është gjithashtu e angazhuar në hartëzimin dhe analizimin e veprimtarisë së fondacioneve komunitare dhe në shpërndarjen e informacionit që do të lehtësojë zhvillimin e kësaj fushe.


Një nga shtyllat e të mësuarit është organizimi i takimeve tematike ndërmjet kolegëve me përfitimin e të mësuarit të ndërsjellë, ndarjen e përvojave dhe planeve në promovimin e konceptit të fondacioneve komunitare në shtetet me më pak ose aspak përvojë me këtë formë filantropie. Shqipëria është ndër shtetet evropiane në zhvillim, dhe Partnerët Shqipëri ka marrë pjesë në rreth 8 takime duke ndarë dhe diskutuar me kolegët evropianë, sfidat dhe arritjet në lidhje me krijimin e fondacioneve komunitare në nivel kombëtar.

ECFI vazhdon të publikojë Thirrje për Propozime në mbështetje të fondacioneve komunitare dhe organizatave mbështetëse të fondacioneve komunitare, dhe ju mund të gjeni më shumë informacion në <https://www.communityfoundations.eu/home.html>

42




**G L O B A L**  
**G I V I N G I N D E X**  
**2 0 2 1**



Në Raportin e Indeksit Global të Dhurimit 2021, Shqipëria renditet në vendin e 65-të midis 150 vendeve. Krahasuar me raportin e fundit, Shqipëria është përmirësuar ndjeshëm duke u ngjitur me 40 vende. Progres është arritur në tre sjelljet e dhurimit: ndihma ndaj një të huaji, dhurimi i mjeteve monetare dhe koha vullnetare e dedikuar tek një organizatë duke konfirmuar solidaritetin e shqiptarëve në kohë situatash pandemike.





## *-Shteti më bujar në botë është Indonezia.!*

Indonezia renditet e para në Indeksin e Global të Dhurimit me një rezultat prej 69, nga 59 herën e fundit që u publikua një indeks vjetor në 2018, në të cilin gjithashtu renditej e para. Më shumë se tetë në 10 indonezianë dhuruan mjete monetare këtë vit dhe shkalla e vullnetarizmit në vend është më shumë se trefishi i mesatares globale.

## *-10 shtetet më bujare kanë ndryshuar në vitin 2020.*

Shumë nga shtetet të cilat vazhdimisht janë përfshirë në 10-tëshen më të mirë kanë zbritur shumë poshtë në renditjen e këtij raporti. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Mbretëria e Bashkuar, Kanadaja, Irlanda dhe Holanda kanë pësuar të gjitha ulje të ndjeshme në rezultatet e tyre sipas Indeksit. Pas rikuperimit nga një rënie në 2016, secili shtet regjistroi një prirje të lehtë rënie nga 2018, por 2020 shënoi një rënie të konsiderueshme në renditje.

## *-Në vend të tyre shfaqen disa shtete të reja në Top 10 - Nigeria, Gana, Uganda dhe Kosova.*

Ashtu si pjesa më e madhe e botës perëndimore, Australia dhe Zelanda e Re gjithashtu shënuan një rënie të rezultateve nga viti 2018 dhe Indeksi për të dy vendet mbetet nën mesataren e tyre afatgjatë. Sidoqoftë, të dy mbeten në Top 10-shen e këtij viti - të vetmet shtete me të ardhura të larta pjesë e këtij grupimi. Qëndrueshmëria e dhurimit në Australi dhe Zelandën e Re e theksuar në këtë raport ka të ngjarë të lidhet me kohën e zhvillimit të studimit në këto shtete, i cili u krye disa javë para kulmit të valës së parë të pandemisë. Për më tepër, në Australi, pati një solidarizim të gjerë dhe bujar ndaj zjarreve në fillim të vitit 2020.

## *-Më shumë se tre miliardë njerëz ndihmuan dikë që nuk e njihnin në vitin 2020.*

Globalisht, më shumë njerëz raportuan se ata ndihmuan një të huaj në vitin 2020 sesa është regjistruar më parë në Indeksin Botëror të Dhurimit. Ndihma për një të huaj është sjella më e zakonshme e dhurimeve në të gjithë botën - mbi gjysma (55%) e popullsisë në moshë madhore në botë e bëri këtë në vitin 2020, ose përafërsisht më shumë se tre miliardë njerëz.

## *-Pavarësisht, ose ndoshta për shkak të pandemisë, dhurimi në vlerë monetare është rritur në të gjithë globin.*

Më shumë njerëz dhuruan para në vitin 2020 sesa kishin bërë në pesë vitet e fundit (31%) ndërsa nivelet e vullnetarizmit në vitin 2020 mbetën relativisht të paprekura në nivel global. Sidoqoftë, kjo gjetje maskon ndryshimet shumë të rëndësishme në Indeksin e përgjithshëm të këtij viti.







Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,  
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1  
1010 Tirana, Albania